

# “TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË”

## Bashkia e Përmetit

Kjo analizë u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrjetit të organizatave “Zëri i të rinjve”, me mbështetjen e UNFPA-së.

Dhjetor 2018





## Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për Ietje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori)

Rr. "Blv. Bajram Curri" Nd. 136, H. 14, Ap. 1

Njësia Administrative Nr 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00355 42 258 987

Email: [info@observator.org.al](mailto:info@observator.org.al)

Webmail: [www.observator.org.al](http://www.observator.org.al)

Kjo analizë është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB: UNDP, UNFPA, UNICEF, dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

### EKSPERTE E ANALIZËS

Monika Kocaqi

### EKIPI MENAXHUES

Elma Tërshana

Eridjona Vallja

Andi Rabiaj

### SUPERVIZUESE

Elida Nuri

Një falenderim i shkon stafit të Bashkisë së Përmetit që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundësuar të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar dhe realizuar për të rejtat dhe të rinjtë. Në veçanti falenderojmë Z. Niko Shupuli – Kryetar i Bashkisë Përmet, Znj. Denisa Mamillo – Përgjegjëse e Programim Zhvillimit në Bashki dhe Znj. Klaudia Naqellari – Specialiste e projekteve në Bashki.

*Përmbytja* e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të rinjve". Opinionet e shprehura këtu janë të autorëve/eve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së.

## PËRSE BUXHETIMI “PËR RININË” DHE “ME RININË”?

Rinia në Shqipëri është pjesë e programit dhe politikave të qeverisë dhe citohet si grup prioritar në dokumenta të veçantë të hartuar për këtë qëllim. Ofrimi i një tërësie shërbimesh dhe informacionesh edukuese në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit, zhvillimit ekonomik, kulturës, sportit, argëtimit, mjedisit e vullnetarizimit, si dhe angazhimi i rinisë në proceset planifikuese e vendim-marrëse, është domosdoshmëri<sup>1</sup>. Këto shërbime mund dhe duhet të ofrohen kryesisht nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë), të cilat janë më afër qytetar/eve dhe njohin më mirë nevojat e tyre.

Të rejtat dhe të rinjtë duhet të jenë pjesë e iniciativave planifikuese e zhvilluese të ndërmarra si në nivel qendror ashtu edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sidomos nga bashkitë.

**Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”** në nenin 38 pika 2 të tij kërkon shprehimisht që, pas finalizimit të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij dhe më pas organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit<sup>2</sup>. Në këtë kuadër, bashkitë mund dhe duhet të mbështetin iniciativat e tyre planifikuese buxhetore për të rejtat dhe të rinjtë në nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjislacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim. Si dy nga më të rëndësishmet mund të përmendim:

**1. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë. Konkretisht këto detyrime evidentohen në:

**(i)** nenin 3 ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, në pikat d), dh) dhe f) sipas të cilave realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

**(ii)** nenin 23 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj);

**(iii)** nenin 24 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e shërbimeve sociale;

**(iv)** nenin 25 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;

**(v)** nenin 26 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit;

**(vi)** nenin 28 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;

**(vii)** nenin 29 ku përcaktohen funksionet e bashkësisë në fushën e sigurisë publike.

Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendim-marrjes, shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

**2. Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (PKVR) 2015-2020**, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 383, datë 6 maj 2015, është një ndër dokumentat kryesorë që udhëheq punën e qeverisjes qendrore si dhe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për veprime dhe masa për të rejtat dhe të rinjtë në Shqipëri.

<sup>1</sup>Fushat e mësipërme përbëjnë dhe thelbin e objektivave të përgjithshme të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020

<sup>2</sup>Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16

Qëllimi këtij plani është zhvillimi dhe koordinimi i politikave ndërsektoriale rinore në edukim, punësim, shëndetësi e kulturë, si dhe forcimi i pjesëmarrjes së të rejave e të rinjve në jetën shoqërore dhe proceset vendimmarrëse. Misioni i Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020, qartësisht evidenton nevojën për *“përmirësim të cilësisë së jetës së të rejave e të rinjve dhe forcim të statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë, si dhe rritje të pjesëmarrjes së plotë të tyre në shoqëri dhe vendim-marrje”*<sup>3</sup>. Bazuar mbi këtë dokument strategjik, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të hartojnë dhe zbatojnë planet e tyre të veprimit në nivel vendor, duke synuar përmbushjen e misionit dhe qëllimit të sipërcituar.

## SI PARAQITET SITUATA NË BASHKINË E PËRMETIT?

Në planifikimet dhe ndërhyrjet në shërbim të komunitetit – pra përfshirë edhe rininë – Bashkia e Përmetit orientohet kryesisht përmes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 dhe strategjisë së zhvillimit lokal, ndërsa në terma buxhetorë, është përgatitur Plani Buxhetor Afatmesëm 2018–2020, mbi bazën e të cilit, në përputhje me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore, bëhet dhe planifikimi buxhetor vjetor.

Bazuar në informacionin e dhënë nga bashkia, situata në lidhje me të rejtat dhe të rinjtë paraqitet si në vijim:

- Bashkia e Përmetit *disponon të dhëna të sakta* të numrit të të rejave dhe të rinjve të grupmoshës 15–29 vjeç (sipas këtyre të dhënave në bashkinë e Përmetit jetojnë 5325 të reja e të rinj të kësaj grupmoshe).
- Në Përmet ka gjithsej 2 (dy) shkolla të mesme dhe një qendër shumë-funksionale, por **nuk ka qendër rinore**. Po kështu mungojnë edhe organizatat lokale rinore.
- Prej një viti tashmë rezulton i ngritur *Këshilli Rinor pranë bashkisë* (shtator 2017), që përbëhet nga 13 të reja e të rinj të regjistruar/a me dëshirën e tyre, pas njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të bashkisë si dhe në shkolla. Ky Këshill është ngritur me iniciativën e Korpunit të Paqes, megjithatë përgjatë një viti Këshilli Rinor nuk ka qenë shumë aktiv.
- *Nuk ekziston një plan sektorial për kujdesin shëndetësor* apo *një plan për shërbimet sociale* ku të jetë përfshirë edhe kujdesi shëndetësor, por bashkia *ka të emëruar në strukturën e saj një punonjës*, si specialist i shëndetësisë.
- *Nuk ekziston një plan sektorial për rininë* (që të bazohet dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë), ndonëse në institucionet arsimore zhvillohen aktivitete kryesisht informuese e ndërgjegjësuese me të rejtat dhe të rinjtë e grupmoshës 15 – 18 vjeçare. Po kështu në Bashki *nuk ka ndonjë drejtori apo sektor të veçantë përgjegjës për çështjet e rinisë* dhe *as specialist/e të emëruar për këtë qëllim*.
- Bashkia *ka zbatuar programe për të rejtat dhe të rinjtë* në tre vitet e fundit (2015–2017) *të fokusuar kryesisht në aktivitete kulturore dhe trajnime* (që zhvillohen në bashkëpunim me shoqata të ndryshme). Për *vitin 2018*, veç këtyre programeve, është parashikuar dhe po zbatohet edhe *Programi i “Këndit të BE-së”*<sup>4</sup>. Gjithashtu në 29.05.2018, Bashkia Përmet ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi 2 vjeçare me *Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, në emër të rrejtit të organizatave “Zëri i të Rinjve”*, me qëllim mobilizimin, integrimin dhe fuqizimin e potencialeve të të rejave dhe të rinjve përmes shërbimeve ndërgjegjësuese, informuese, avokuese e lobuese, në fushat e edukimit, kujdesit, shëndetit dhe punësimit.

<sup>3</sup>Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015–2020, fq.9

<sup>4</sup>Të dhëna më të detajuara mbi aktivitetet dhe programet e zbatuara për rininë gjatë tre viteve të fundit pasqyrohen në shtojcën 1.

- Këshilli Bashkiak *nuk ka zhvilluar seanca dëgjimore dedikuar çështjeve të shëndetit publik apo rinisë*. Megjithatë të rejat e të rinjtë kanë mundësi të ngrenë zërin për problemet që i shqetësojnë dhe kanë theksuar *nevojën për ngritjen e një qendre rinore*, si dhe *nevojën për më shumë aktivitete për grupmoshën e tyre*.
- Buxheti i bashkisë dedikuar direkt ose indirekt rinisë *është pjesë e programeve të Arsimit, Kulturës dhe Sportit*. Buxheti për rininë i planifikuar dhe realizuar gjatë tre viteve të fundit në këto programe *rezulton të ketë pësuar rritje*, siç paraqitet në tabelën në vijim:

VITI <sup>5</sup>	KATEGORIA	BUXHETI PLANIFIKUAR (LEKË)	BUXHETI REALIZUAR (LEKË)
2016	Arsimi	36,005,000	31,668,349
	Kultura	7,650,000	6,242,244
	Sporti	4,000,000	3,731,606
	<b>TOTAL</b>	<b>47,655,000</b>	<b>41,642,199</b>
2016	Arsimi	41,949,000	33,347,537
	Kultura	9,192,000	7,202,045
	Sporti	4,200,000	3,815,137
	<b>TOTAL</b>	<b>55,341,000</b>	<b>44,364,719</b>
2016	Arsimi	51,308,000	
	Kultura	10,337,000	
	Sporti	4,200,000	
	<b>TOTAL</b>	<b>65,845,000</b>	

- Njoftimet e ndryshme mbi edukimin, trajnimin apo bursat për të rejat dhe të rinjtë pasqyrohen on-line në faqen e internetit të bashkisë: [www.bashkiapermet.gov.al](http://www.bashkiapermet.gov.al)
- Bashkia *nuk ka bërë ndonjë vlerësim/anketim për të identifikuar nevojat dhe prioritetet* e të rejave dhe të rinjve në Përmet. Megjithatë kur pyetet për rëndësinë e aktiviteteve me fokus shëndetin seksual e riprodhues si dhe ato sensibilizuese për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, bashkia i vlerëson ato si aktivitete tepër të rëndësishme, së bashku me: pasjen e një manuali shpjegues për të rejat e të rinjtë për t'u njohur me të drejtat e tyre mbi shëndetin e kujdesin shëndetësor; shkëmbimin e eksperiencave mes të rejave e të rinjve nga bashki të ndryshme me ndërmjetësimin e drejtuesve vendorë, etj.

Ndërkohë, nga një anketim i kryer nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Femijëve dhe të Rinjve, me 100 të reja e të rinj të bashkisë së Përmetit (51% vajza dhe 32% nga zonat rurale të njësisë administrative Petran e Piskovë), gjatë periudhës prill-maj 2018, rezulton se:

<sup>5</sup> Bashkia nuk disponon të dhëna për buxhetin e planifikuar dhe zbatuar për vitin 2015 (këto të dhëna i përkasin periudhës së qeverisjes nga kryetari i mëparshëm, për të cilat nuk mban përgjegjësi dhe nuk ka përse të shprehet kryetari dhe punonjës/et aktual/e)

- Afërsisht **1 në 7 të reja dhe të rinj** kanë dëgjuar se çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals - SDGs). **Interneti** dhe **shkolla** janë burimet më të shpeshta të marrjes së këtij informacioni për të rejtat dhe të rinjtë e zonave urbane, në masën 33% secila, ndërsa institucionet lokale janë cituar si burim informacioni nga 50% e të rejave dhe të rinjve të zonave rurale. **Familja** nuk është cituar si burim informacioni nga asnjë nga të rejtat dhe të rinjtë e zonave urbane apo rurale.
- Vetëm **6% e të rejave dhe të rinjve shprehen se janë përfshirë personalisht në arritjen e SDG-ve**; ndërsa **31% e të rejave dhe të rinjve shprehen se dëshirojnë të përfshihen, por nuk kanë informacionin e nevojshëm se si mund të ndodhë kjo gjë.**
- **1 në 4 të reja dhe të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion** mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.
- Të rejtat dhe të rinjtë **më të informuar** mbi shëndetin seksual dhe riprodhues janë **vajzat në zonat urbane (37%)**, ndërsa **më pak të informuar janë vajzat në zonat rurale (11%)**. Shkolla dhe interneti janë burimi më i shpeshtë i informacionit të përdorur për pasurimin e njohurive të të rejave dhe të rinjve mbi këtë çështje.
- **Shumica e të rejave dhe të rinjve (49%)** shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është **pjesërisht i mjaftueshëm**. **23% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane** shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është **i mjaftueshëm**, përkundrejt **8% të të rejave dhe të rinjve në zonat rurale**.
- **56% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale** dhe **29% në zonat urbane nuk flasin me prindërit** e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Vetëm **16% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane** dhe **9% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale** pohojnë se flasin me prindërit e tyre. **3% e të rejave në zonat urbane** shprehen se **prindërit nuk i lejojnë** të komunikojnë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues në familjet e tyre.
- **1 në 2 të reja dhe të rinj** janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të bashkisë në lidhje me rininë (kryesisht djemtë në zonat rurale, në masën 33%).
- Shumica e të rejave dhe të rinjve (40% në zonat urbane dhe 28% në zonat rurale) shprehen se **nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në takimet** që bashkia ka zhvilluar me të rejtat dhe të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës. 34% e të rejave dhe të rinjve nga zonat urbane dhe 34% e të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale janë shprehur se kanë marrë pjesë ndonjëherë.
- **Aktivitetet promovuese dhe gjithëpërfshirëse, takimet e vazhdueshme informuese** dhe trajnimet janë programet më të preferuara që të rejtat dhe të rinjtë do të donin të përfitonin nga bashkia e Përmetit. Gjithashtu të rejtat dhe të rinjtë kanë identifikuar si shërbime të preferuara edhe ofrimin e ambienteve sportive, punësimin, ngritjen e qendrës rinore, e-shërbimet si dhe ofrimin e bursave.ëherë në takimet e organizuara nga bashkia. Ndërsa 7% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane shprehen se **marrin pjesë gjithmonë** në takimet e bashkisë.

## ÇFARË MUND TË PËRFSHIHET NË BUXHETIN E VITIT 2019 PËR RININË?

Bashkia e Përmetit, në përmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi të saj për përmirësimin e situatës së të rejave dhe të rinjve përmetar/e, si dhe në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015–2020 mund të përfshijë në planifikimin buxhetor për vitin 2019, disa nga veprimet që përshkruhen në vijim:

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	SHËNIME
1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rejave dhe të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike	1.1 Përmirësimi i performancës së Këshillit Rinor, përmes shtimit të antarësisë dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive të tij në proceset vendimmarrëse të Bashkisë. (Rëndësi duhet t'i jepet përbërjes së Këshillit Rinor që duhet të respektojë balancën gjinore dhe përfaqësimin e të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara, si persona me aftësi të kufizuara, minoriteti Rom, Egjiptjan, komuniteti LGBTI, etj).	– Janar 2019: Përmirësimi i përbërjes / antarësisë së Këshillit Rinor  – 2019 – e në vijim: Aktivizimi i këtij Këshilli në mbledhjet dhe proceset vendimmarrëse të bashkisë.	– Lista e përditësuar e antarë/eve të Këshillit Rinor, publikuar në faqen e internetit të bashkisë.  – Pjesëmarrja dhe diskutimi i tyre pasqyruar në proces-verbalet e mbledhjeve përkatëse.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 1, aktivitetin 1.2.2 të PKVR 2015–2020.  Ai mund të kryhet në bashkëpunim me rrjetin e organizatave “Zëri i të rinjve”, si dhe me të rejtat dhe të rinjtë në shkolla.
	1.2 Aktivitete sensibilizuese me qëllim zvogëlimin e stereotipeve/diskriminimit gjinor dhe përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe jetën publike.	Gjatë gjithë vitit 2019	– Numri i aktiviteteve me fokus diskriminimin gjinor dhe përfshirjen e rinisë në vendimmarrje, të organizuara nga bashkia në shkollat e mesme dhe nëntë-vjeçare të qytetit dhe të njësive administrative përreth.  – Numri i të rejave dhe të rinjve të pranishëm si dhe që japin mendim në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo seancat / dëgjesat publike që organizon bashkia për çështje të	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 1, aktivitetin 1.2.3 të PKVR 2015–2020.  Nëpunësja e Barazisë Gjinore në bashki mund ta përfshijë organizimin e aktiviteteve të tilla në shkolla si pjesë të punës edukuese / informuese për çështjet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

			ndryshme	
<b>2. Nxitja e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës</b>	2.1 Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Përmetit, në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen nga Agjensia e Formimit Profesional (AFP) për të rejtat dhe të rinjtë përmetar/e.	Janar–Mars 2019: Vlerësimi i situatës  Prill 2019 – e në vijim: Propozimet dhe hapat konkretë deri në ngritjen e programeve të reja të formimit profesional për të rejtat dhe të rinjtë përmetar/e	– Raporti i vlerësimit të situatës – Propozimet drejtuar AFP dhe Zyrës Rajonale të Punësimit (ZRP) Gjrokastër, përmes Zyrës Vendore të Punësimit (ZVP) Përmet mbi kurset e reja të formimit profesional që duhet të hapen në Përmet. – Numri i kurseve të reja të hapura nga AFP.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.2.6 të PKVR 2015–2020.  Ai duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me AFP, ZRP dhe ZVP, si dhe me bizneset ekzistuese të zonës.
	2.2 Organizimi i takimeve sensibilizuese me të rejtat dhe të rinjtë mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional të bazuara në nevojat dhe specifikat e zonës.	Prill – Dhjetor 2019	– Numri i takimeve të organizuara në shkolla. – Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e në këto takime. – Numri i të rejave dhe të rinjve të regjistruar/a në kurset e formimit profesional.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.2.7 të PKVR 2015–2020.
	2.3 Mbështetja e aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale	Gjatë gjithë vitit 2019	– Numri i aktiviteteve vetëpunësuese të mbështetura. – Numri i të rejave dhe të rinjve të vetëpunësuar/a.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 2, aktivitetin 2.3.4 të PKVR 2015–2020.
<b>3. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete mjedisore</b>	3.1 Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rejave dhe të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore në nivel lokal.	Gjatë gjithë vitit 2019	– Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë aktivisht në seancat e Këshillit Bashkiak, dëgjuesat publike apo aktivitete mbi mjedisin, të organizuara nga bashkia.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 3, aktivitetin 3.7.2 të PKVR 2015–2020.

	3.2 Aktivitete pastrimi, pyllëzimi apo riciklimi me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rejave dhe të rinjve, si dhe komunitetit në tërësi mbi mbrojtjen e mjedisit.	Gjatë gjithë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i aktiviteteve sensibilizuese të organizuara.</li> <li>- Numri i pemëve të mbjella dhe sasia e plehrave të grumbulluara apo ricikluara.</li> </ul>	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 3, aktivitetin 3.7.5 të PKVR 2015–2020.
	3.3 Aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e gjeneratës së re.	Gjatë gjithë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i aktiviteteve të zhvilluara.</li> <li>- Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.</li> </ul>	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki.
4. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete artistike e kulturore	4.1 Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër, animacione) të krijuara nga të rejtat dhe të rinjtë e shkollave të Përmetit dhe përfshirja e tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme të qytetit.	Gjatë gjithë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i grupeve të reja rinore të mbështetura.</li> <li>- Numri i aktiviteteve të bashkisë në të cilat janë të ftuara dhe kanë performuar këto grupe rinore.</li> </ul>	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 6, aktivitetin 6.1.2 të PKVR 2015–2020.
	4.2 Promovimi i jetës artistike dhe kulturore përmes organizimit të aktiviteteve artistike-kulturore edhe në zonat rurale (njësitë administrative Petran, Piskovë, Çarçovë, etj).	Gjatë gjithë vitit 2019	- Numri i aktiviteteve artistike-kulturore të organizuara me mbështetjen e bashkisë, në zonat rurale, me grupet rinore.	Ky veprim është në përputhje me objektivin strategjik 6, aktivitetin 6.2.1 të PKVR 2015–2020.
5. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore	5.1 Aktivitete që promovojnë një kulturë të hapur dhe të lirë rreth shëndetit seksual, për të ulur stigmatizmin dhe diskriminimin.	Gjatë gjithë vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale.</li> <li>- Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.</li> </ul>	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe në mënyrë të veçantë specialisti i shëndetit në Bashki.
	5.2. Krijimi dhe mbështetja e grupeve “edukatorë bashkëmohatarë”		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupet e “edukatorëve bashkëmohatarë” të krijuara.</li> <li>- Numri i aktiviteteve të organizuara nga grupet e</li> </ul>	Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki në bashkëpunim me

	<p>("peer education groups") për nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukuese shëndetësore mes të rejave dhe të rinjve në zonat rurale, si dhe në komunitetin Rom, Egjiptjan, LGBTI, etj.</p>		<p>"edukatorëve bashkëmohatarë" me të rejtat dhe të rinjtë e zonave apo komuniteteve të caktuara.</p>	<p>Rrjetin e organizatave "Zëri i të rinjve".</p>
	<p>5.3 Konkurse mes shkollave të mesme mbi rolin e qeverisjes vendore në çështje të shëndetit seksual dhe riprodhues.</p>	<p>Gjatë ditëve dedikuar shëndetit përgjatë vitit 2019</p>	<p>– Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale. – Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.</p>	<p>Ky veprim mund të jetë pjesë e aktiviteteve që duhet të organizojë Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki.</p>
<p><b>6. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (Sustainable Development Golas – SDGs)</b></p>	<p>6.1. Aktivitete informuese mbi SDG-të me qëllim njohjen e tyre dhe sensibilizimin e të rejave dhe të rinjve mbi rolin që mund dhe duhet të luajnë për përmbushjen e këtyre objektivave.</p>	<p>Gjatë gjithë vitit 2019</p>	<p>– Numri i aktiviteteve me fokus SDG-të, të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Rrjetin "Zëri i të rinjve" në shkollat e mesme të qytetit.</p>	<p>Në realizimin e aktiviteteve të tilla mund të angazhohet jo vetëm Nëpunësja e Barazisë Gjinore por edhe stafi përgjegjës në bashki për çështje të edukimit.</p>
	<p>6.2. Mbështetja e iniciativës "Rinia përmetare për SDG-të", përmes hartimit dhe financimit për zbatimin e një plani veprimesh konkrete në këtë drejtim.</p>	<p>Janar – Qershor 2019: Hartimi i dokumentit të planit të veprimeve për përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në arritjen e SDG-ve.</p>	<p>– Dokumenti i Planit të Veprimeve për arritjen e SDG-ve përmes kontributit të të rejave dhe të rinjve përmetar/e. – Numri i iniciativave të financuara nga bashkia, për t'u zbatuar nga të rejtat dhe të rinjtë përmetar/e në kuadër të SDG-ve.</p>	<p>Bashkëpunimi me Rrjetin "Zëri i të rinjve", si dhe me akademikët dhe median, lehtëson zhvillimin e aktiviteteve të tilla dhe ndihmon në prezantimin e ideve inovative për të kontribuar për arritjen e SDG-ve.</p>

		Korrik – Dhjetor 2019, e në vijim: Zbatimi i planit të hartuar, duke ofruar mbështetjen e duhur financiare, infrastrukturore, etj.		
	6.3. Panairi i ideve në kuadër të "Ditës Botërore të Aftësive të të rejave dhe të rinjve" <sup>6</sup> , bazuar në trajnimet e formimit profesional të ofruara mbi bazën e nevojave dhe karakteristikave të zonës.	15 Korrik 2019	- Panairi i organizuar në bashkëpunim me AFP dhe ZRP. -Numri i ideve të prezantuara. -Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Ky aktivitet është në përputhje me SDG 4 "Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës e të barabartë për të gjithë dhe nxitja e mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës". Aktiviteti mund të kombinohet (dhe kontribuon) edhe me veprimet e planifikuara në qëllimin 2, të fokusuar tek rinia dhe nxitja e punësimit (siç paraqiten më sipër në këtë tabelë).

<sup>6</sup>Për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e investimit në zhvillimin e aftësive të të rejave dhe të rinjve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi në Rezolutën A/RES/69/145 që data 15 Korrik të njihet si Dita Botërore e Aftësive të të rejave dhe të rinjve (World Youth Skills Day). Për më shumë informacion vizitoni faqen: <http://www.un.org/en/events/youthskillsday/index.shtml>

## **ÇFARË HAPASH DUHET TË HEDHË BASHKIA PARALELISHT ME PËRFSHIRJEN NË BUXHETIN E VITIT 2019 TË DISA PREJ VEPRIMEVE TË PROPOZUARA MË SIPËR?**

- Të përditësojë bazën e të dhënave (databazën) në lidhje me numrin e të rejave dhe të rinjve në qytet dhe zonat rurale pjesë e territorit të bashkisë, duke siguruar që kjo bazë të dhënash të përmbajë detaje mbi gjininë, moshën, aftësitë e kufizuara të tyre, etninë, orientimin seksual, vendbanimin, etj.
- Të aktivizojë dhe nxitë pjesëmarrjen e Këshillit Rinor jo vetëm në takime dhe dëgjesa me fokus çështjet e rinisë, por edhe në takime dhe dëgjesa publike që bashkia organizon për çështje të ndryshme të lidhura me shëndetësinë, arsimin, punësimin, zhvillimin ekonomik, etj.
- Të bashkëpunojë me rrjetin “Zëri i të Rinjve” me qëllim ofrimin e modelit për nxitjen e krijimit të grupeve dhe shoqatave rinore, nga të rejtat dhe të rinjtë e qytetit dhe të zonave rurale pjesë e territorit të bashkisë.
- Të organizojë sesione të hapura dhe dëgjesa publike me fokus të veçantë të rejtat dhe të rinjtë dhe nevojat e tyre. Për të siguruar pjesëmarrjen në këto sesione apo dëgjesa, të organizojë fillimisht takime të shkurtra informuese në shkollat e qytetit dhe të zonave rurale, ku të ftohen të rejtat dhe të rinjtë të bëhen pjesë e dëgjesave që do të organizojë bashkia. Në këto takime duhet të paraqitet dhe kalendari i dëgjesave që mendohet të organizohen. Një kopje e këtij kalendari me datat, oraret dhe vendin e organizimit të këtyre dëgjesave duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.
- Të marrë masa për të caktuar një specialist/e që në përshkrimin e punës së saj/tij të ketë detyra që lidhen specifikuat me rininë dhe ndjekjen e prioriteteve të saj.
- Të marrë masa që të koordinojë aktivitetet shëndetësore, edukuese e kulturore me prioritetet që lidhen me rininë në këto drejtime. Të mundësojë shkëmbime eksperiencash me bashki të tjera ku grupimet rinore janë më aktive.
- Të hartojë një plan veprimi lokal për rininë, ku të përmbliiden të gjitha veprimet e parashikuara në dokumenta të tjerë zhvillimorë të bashkisë, por edhe veprime të tjera të domosdoshme për adresimin e çështjeve rinore në fusha të ndryshme. Ky plan veprimi duhet të mbështetet në PKVR 2015–2020 (pjesë e këtyre veprimeve janë dhënë në tabelën mësipër me sugjerime për aktivitetet që duhet të përfshihen në buxhetin e vitit 2019 të bashkisë Përmet, me fokus rininë).
- Të marrë masa që në takimet dhe dëgjesat për përfundimin e buxhetit vjetor 2019, të sigurojë pjesëmarrjen e Këshillit Rinor, si dhe të të rejave dhe të rinjve nga grupe të ndryshme (përfshirë edhe nga grupet e pafavorizuara si Romë, Egjiptjanë, PAK, LGBTI, etj). Bashkëpunimi me rrjetin e organizatave “Zëri i të rinjve” është i domosdoshëm në këtë drejtim, sidomos për të siguruar pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupet e ndryshme të sipërcituara, të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale, etj.

## SHTOJCË 1

VITI 2016		
TITULLI I AKTIVITETIT	QËLLIMI	INFORMACION I SHKURTËR
Dita Naimiane  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1388">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1388</a>	Të përkujtohet 170-të vjetori i lindjes së poetit kombëtar Naim Frashëri	Aktiviteti u organizua nga Bashkia Përmet dhe "Shoqata Atdhetare Kulturore Mbarëkombetare Vëllezërit Frashëri". Në këtë aktivitet të zhvilluar në Frashër, aty ku poeti u lind dhe mori mësimet e para, u përkujtua jeta dhe krijimtaria e tij. Po kështu, z. Rexhep Qosja iu dha titulli "NDERI I QYTETIT TË PERMETIT" me motivacion: atdhetar, personalitet i rëndësishëm i letrave kombëtare shqipe; një zë i kthjellët intelektual i ndërgjegjjes kombëtare, i denjë i udhës së Frashërllinjve; në dobi të çështjes kombëtare shqiptare; studiuesi më i madh i veprës së Naim Frashërit.
Festivali Përmeti Multikulturor  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1332">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1332</a>	Të njihet dhe ekspozohet tradita dhe kultura përmetare	
Festivali Përmeti Multikulturor  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1332">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1332</a>	Të organizohen veprimtari sportive me qëllim aftësimin e fëmijëve në sportin e futbollit	Kampionati i 36 i futbollit për fëmijë "FUNKY CUP" ndërmjet lagjeve të qytetit; fitues kampionati shpallet lagjia "MEJDEN"
Dita e Trashëgimisë Kulturore  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1224">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1224</a>	Të organizohen veprimtari sportive me qëllim aftësimin e fëmijëve në sportin e futbollit	Organizuar në datën 29.09.2016 nga Bashkia Përmet në bashkëpunim me projektin arkeologjik "Memola" dhe DRKK Gjirokastër. Në këtë aktivitet u bë prezantimi i rezultateve nga gërmimet arkeologjike që po kryheshin përgjate Luginës.
VITI 2017		
Dita e Verës dhe çelja e Sezoni Turistik  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2120">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2120</a> <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2054">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2054</a>	Të zyrtarizohet çelja e sezonit turistik	Bashkia Përmet në mbështetje të Ministrisë së Kulturës, organizatës CESVI, Convivium-it "SlowFood Përmet" dhe shoqërisë Pro Përmet, çelën sezonin turistik pasditen e datës 22 Prill 2017 në sheshin e qytetit. Aktivitetin e shoqëruan trupa e Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Sazet e Mjeshtrave Përmetarë. Gjithashtu nuk munguan lojëra popullore dhe promovimi i pasurive natyrore dhe traditës së gatimit.
Olimpiada e Lojërave Lëvizëse Popullore:  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2030">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2030</a>	Të organizohen veprimtari sportive me qëllim aftësimin e të rejave dhe të rinjve në lojërat lëvizëse popullore	Bashkia Përmet, në bashkëpunim me Zyrën Arsimore dhe disa shoqata, organizoi Olimpiadën e Lojërave Lëvizëse Popullore. Pjesëmarrës/e në këtë veprimtari ishin rreth

		<p>900 fëmijë të shkollave 9 vjeçare, të cilët interpretuan rreth 50 lojëra të ndryshme popullore. Ky aktivitet synonte të ndërjegjësonte fëmijët dhe të rejat e të rinjtë mbi rëndësinë e njohjes, ruajtjes dhe zhvillimit të traditave më të mira të kulturës përmëtare.</p>
<p>Dita Naimiane:  <a href="http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1944">http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1944</a></p>	<p>Të përkujtohet 171-një vjetori i lindjes së poetit të madh kombëtar Naim Frashëri</p>	<p>Bashkia Përmet, me rastin e 171 vjetorit të lindjes së poetit kombëtar Naim Frashëri, organizoi një festë letraro-artistike në ambientet e Qendrës Multifunkionale. Po kështu, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Klubin e shkrimtarëve dhe artistëve "Naim Frashëri", organizuan një mbrëmje poetike, pjesë e së cilës ishte edhe konkursi i poezisë, ku poetët nga të gjitha trevat shqiptare morën pjesë me krijimet e tyre.</p>
<p>Festivali Përmeti Multikulturor  <a href="http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1829">http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1829</a></p>	<p>Të organizohen veprimtari kulturore artistike që përfshijnë folklorin e minoriteteve dhe etnive që bashkëjetojnë në vendin tonë.</p>	<p>Mbyllet edicioni i 15-të i Festivalit Folklorik Ndërkombëtar "Përmeti Multikulturor", organizuar nga Bashkia Përmet në bashkëpunim me CIOFF dhe Ministrinë e Kulturës. Ansambli i Qendrës Kulturore Tiranë, Ansambli i qytetit të Konicës në Greqi, Sazet e Përmetit, Grupi i Valleve të Dropullit dhe Elbasanit e Fierit ishin disa prej grupeve pjesëmarrëse në festival.</p>
<p>Kampionati i Ping Pongut  <a href="http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1882">http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1882</a></p>	<p>Të organizohen veprimtari sportive për aftësimin e grupmoshave të ndryshme në këtë sport</p>	<p>Kampionati Kombëtar i Ping-Pong-ut për moshat 12 vjeçare (U12) u zhvillua në ambientet e Pallatit të Sportit Përmet. Në ditën e parë u zhvilluan ndeshjet e ekipore, ku merrnin pjesë lojtarë nga 7 rrethe si: Përmeti, Tirana, Durrësi, Berati, Vlora, Elbasani dhe Burreli. Përmeti arriti të shpallej Kampion i Shqipërisë për vitin 2017, duke fituar të gjitha ndeshjet me rezultatin 3-0. Në ditën e dytë, u zhvilluan ndeshjet individuale. Në përfundim të këtij aktiviteti ku merrnin pjesë 32 lojtarë, Anxhelo Gace nga qyteti i Përmetit, u shpall Kampion i Shqipërisë dhe Kristo Ziso, gjithashtu përmetar, u shpall Nën/Kampion nën trajnimin e z.Ethem Bejo.</p>
<p>Dita Botërore e Trafikimit të Qënieve Njerëzore  <a href="http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1907">http://www.bashkiapemet.gov.al/?page_id=1907</a></p>	<p>Të ndihmojmë në parandalimin dhe sensibilizimin kundër trafikimit të qënieve njerëzore.</p>	<p>Bashkia Përmet organizoi një aktivitet ndërgjegjësuës me rastin e Ditës Botërore kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore. Të ftuar në këtë aktivitet ishin Z. Gazmir Memaj, Menaxher në Mary Ward Loreto dhe kryetar i rrejtit URAT, Serije Pepa, Punonjëse sociale në organizatën "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" dhe Daniel Morton nga Korpusi i Paqes. Gjatë aktivitetit u performua një dramë</p>

		nga nxënësit Albion Barjami, Vangjel Cajupi, Serena Canka, Emila Filipi, Joan Janku, Aleko Lara, Elda Nasto, Eni Sotiri.
Dita e Trashëgimisë Kulturore <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1023">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=1023</a>	Të njohim dhe kuptojmë vlerat e trashëgimisë kombëtare kulturore	Në kuadër të "Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore" dhe "Ditëve Evropiane të Trashëgimisë", Bashkia Përmet, arkeologët e Projektit "MEMOLA", Qendra CERPHAAL dhe Sektori i Kulturës Kombëtare Përmet, organizuan aktivitete dhe veprimtari teorike dhe praktike. Këto aktivitete u shtrinë edhe në shkollat 9-vjeçare të qytetit, ku nxënësit e shkollës "Nonda Bulka" organizuan vizitën në sondazhin arkeologjik dhe nxënësit e shkollës "Meleq Gosnishi" improvizuan një gjermim arkeologjik me qëllim njohjen e vlerave dhe punën e një gjermimi arkeologjik.
Konkursi "Spelling Bee" <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2200">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2200</a>	Të mësojmë të flasim pastër dhe rrjedhshëm gjuhën angleze	Në datën 06.12.2017, u zhvillua "Konkursi i Gërmëzimit" në gjuhën angleze ndërmjet shkollave nëntëvjeçare të Përmetit, Këlcyrës dhe Libohovës. Ky konkurs u zhvillua në bashkëpunim me vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe CESVI-t. I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Z. Donald Lu, i cili drejtoi Konkursin e Gërmëzimit. Nxënësjja Eni Sotiri nga shkolla "Meleq Gosnishi" në Përmet, u shpall fituese e konkursit.
<b>VITI 2017</b>		
Dita e Verës <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2444">http://www.bashkiapermet.gov.al/?page_id=2444</a>	Të organizohet Dita e Verës në Përmet	Festohet për të tretën herë Dita e Verës në Përmet. Sheshi i qytetit ishte plot me vizitorë vendas dhe të huaj. Fëmijët argëtoheshin duke parë nga afër këndin e blegtorisë, ku ishte inskenuar jeta në fshat, ndërsa në sfond shëtitjet nëpër stenda shoqëroreshin nga tingujt e muzikës përmetare dhe asaj moderne. Veçantia e kësaj dite ishte dhe panairi i kulinarisë ku të pranishmit mund të konsumonin produktet e përgatitura nga duart e amvisave përmetare.
Aktivitet në kuadër të Ditës së Autizmit <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2494">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2494</a>	Të jepet informacion mbi autizmin, nevojat që kanë fëmijët autikë dhe prindërit e tyre.	Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjesimit ndaj Autizmit, Bashkia Përmet në bashkëpunim me shoqatën "Solidariteti Tani" organizuan një aktivitet. Të pranishëm ishin edhe ambasadorja e BE dhe deputetja Rudina Hajdari. Kryetari i Bashkisë njoftoi se së shpejti do të ndërtohet një qendër që do t' u shërbejë fëmijëve me autizëm.
<b>AKTIVITETETË ZHVILLUARA NGA PROGRAMI "KËNDI I BE-SË"</b>		
Ekspozita "Të bashkuar në diversitet". <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2688">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2688</a>	Të bëhet e njohur Dita e Diversitetit Kulturor, 21 Maj	Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet, organizoi një ekspozitë në katin e parë të Qendrës Kulturore Multifunkionale. Nxënësit e shkollave nëntëvjeçare paraqitën informacione dhe fakte interesante rreth kulturës së shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, duke treguar se edhe pse të gjitha shtetet janë të ndryshme, jetojnë bashkë në paqe.

		Në qëndrë të ekspozitës ishte paraqitur motoja e BE-së në të 24 gjuhët zyrtare të tij.
Konkursi "EU JEOPARDY GAME" <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2650">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2650</a>	Të bëhet e njohur Java Evropiane	Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet organizoi më 10.05.2018, finalen e konkursit "EU JEOPARDY GAME". Në finale ishin 3 nxënës: Maria Thomollari nga shkolla "Nonda Bulka"; Ksenia Topoviti nga shkolla "Meleq Gosnishi" dhe Virna Cobo nga shkolla "Sami Frashëri". Këto finalistë ishin fitueset e konkursit paraprak që u zhvillua në çdo shkollë, në datat 07-08.05.2018. Fituese u shpall nxënësja Ksenia Topoviti.
Aktivitete të ndryshme në kuadër të Ditës së Tokës <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2569">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2569</a>	Të bëhet e njohur Java Evropiane	Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet organizoi më 10.05.2018, finalen e konkursit "EU JEOPARDY GAME". Në finale ishin 3 nxënës: Maria Thomollari nga shkolla "Nonda Bulka"; Ksenia Topoviti nga shkolla "Meleq Gosnishi" dhe Virna Cobo nga shkolla "Sami Frashëri". Këto finalistë ishin fitueset e konkursit paraprak që u zhvillua në çdo shkollë, në datat 07-08.05.2018. Fituese u shpall nxënësja Ksenia Topoviti.
Aktivitete të ndryshme në kuadër të Ditës së Tokës <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2569">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2569</a>	Të bëhet e njohur Dita e Tokës	Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet në bashkëpunim me Projektin "Bashkitë për Evropë" organizuan Ekspo Forumin "Promovimi dhe cilësia e produkteve lokale". Ky forum mbledhi së bashku fermerët, bizneset lokale, autoritetet vendore, autoritetet qëndrore dhe grupet e tjera të interesit për të diskutuar në lidhje me vështirësitë dhe sfidat që duhet të kenë parasysh prodhuesit lokalë para se të bëhen pjesë e tregut evropian. Aktiviteti u shoqërua me mbjelljen e disa trëndafilave me rastin e Ditës së Tokës, vizitë në panairin e produkteve lokale dhe këndin e riciklimit të plastikës.
Leksione informuese mbi BE-në me nxënëset/it ekselentë të shkollave të qytetit të Përmetit <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2566">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2566</a>	Të jepet informacion mbi BE-në	Gjatë muajit prill kordinatorja lokale e BE-së, në Bashkinë Përmet, organizoi leksione informuese mbi Bashkimin Evropian me rreth 40 nxënës/e ekselentë të shkollave "Nonda Bulka", "Meleq Gosnishi" dhe "Sami Frashëri". Leksionet u zhvilluan çdo javë dhe trajtuan tematikat e mëposhtme: Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian; Institucionet kryesore të BE-së; Traktatet themeluese; Fakte të përgjithshme mbi BE-në; Proçesi i anëtarësimit.
Aktivitet ndërgjegjësues me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Ujit. <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2469">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2469</a>	Të sensibilizohet qyteti për kursimin e UJIT	Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet, iu bashkua nismës globale për të sensibilizuar dhe vepruar për ruajtjen e begatisë më të madhe që njeriut i ka falur natyra, UJIN. Fletëpalosjet dhe materialet e tjera ndërgjegjësuese për kursimin e ujit, të përgatitura nga kordinatorja lokale e BE-së, u shpërndanë më 23.03.2018 në qytet.

<p>Nisma "Shpërnda lumturi"  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2434">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2434</a></p>	<p>Të njihet Dita Ndërkombëtare e Lumturisë</p>	<p>Këndi i BE-së në Bashkinë Përmetiu bashkua nismën globale "Shpërnda lumturi". Shporta e "Lumturisë" shpërndau mesazhe lumturie në qytetin e Përmetit, duke u kthyer buzëqeshjen njerëzve në këtë ditë.</p>
<p>Shfaqja "Të njohim historinë e BE"  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2399">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2399</a></p>	<p>Të njihet historia e BE-së</p>	<p>Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet organizoi më 09.03.2018 me nxënës/it e shkollave nëntë-vjeçare një shfaqje për Historinë e Bashkimit Evropian. Shfaqja filloi me interpretimin e himnit Evropian dhe më pas u tregua historia e BE, që nga fjalimi i Schuman deri tek negociatat me Shqipërinë.</p>
<p>Leksion informues për euron në kuadër të Javës Globale të Parasë.  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2426">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2426</a></p>	<p>Të jepet informacion mbi historikun e euros</p>	<p>Më 19.03.2018, kordinatorja lokale e BE-së në Bashkinë Përmet organizoi një leksion me një grup nxënës/ish ekselentë të vitit të parë dhe të dytë të gjimnazit "Sami Frashëri". Nxënës/eve iu shpjegua historia e euros që nga Traktati i Romës deri në raportin e Delor, kuptimi i emrit, simbolit dhe elementëve kryesorë të kartmonedhave dhe monedhave, eurozona dhe roli i Bankës Qëndrore Evropiane. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës Globale të Parasë.</p>
<p>Aktiviteti "Kujtojmë nenet e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut"  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2392">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2392</a></p>	<p>Të njihet përmbajtja e Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut</p>	<p>Me rastin e 70 vjetorit të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, Këndi i BE-së në Bashkinë Përmet organizoi më 05.03.2018, një aktivitet informues me nxënës/it e shkollave të qytetit. Me anë të një video u shpjeguan 10 nenet e para të Deklaratës</p>
<p>"Të njohim flamujt e shteteve të BE"  <a href="http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2368">http://www.bashkiapermet.gov.al/?p=2368</a></p>	<p>Të njihet flamujt e shteteve anare të BE-së</p>	<p>Gjatë muajit shkurt, një grup nxënës/ish u angazhuan në vizatimin e flamujve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.</p>



